



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1247

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi - Kryetare, Batisha Ibrahim Anëtare, Vedat Poterqoi Anëtar duke vendosur sipas ankesës së OE LCE SH.P.K., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit 119 Programi për ofrimin e shërbimeve të energjisë në ulje të shpenzimeve financiare në Komunën e Prishtinës sipas UA nr.06-2021 me numër të prokurimit 616-24-3272-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna e Prishtinës , më 01/04/2025, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e OE LCE SH.P.K., me nr. 2024/1247, e datës 19/12/2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit “119 Programi për ofrimin e shërbimeve të energjisë në ulje të shpenzimeve financiare në Komunën e Prishtinës sipas UA nr.06-2021” me numër të prokurimit 616-24-3272-2-1-1, (AK) - Komuna e Prishtinës.

2.Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3.Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 04.04.2024 Komuna e Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “119 Programi për ofrimin e shërbimeve të energjisë në ulje të shpenzimeve financiare në Komunën e Prishtinës sipas UA

nr.06-2021 ” me numër të prokurimit 616-24-3272-2-1-1.

Ndërsa me datë 03.12.2024 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate GOE Fuli Inzeniring SH.P.K. & Gregoric Elektromekanika D.O.O.. Tender i përgjegjshëm me Çmimin me te ulet te poentuar prej: 7,970.40 Euro.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë e hapur me llojin e kontratës sherbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 10,000,000.00 euro.

Me 09.12.2024 OE LCE SH.P.K, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 16.12.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 19.12.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE LCE SH.P.K., me nr. 1247/2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit “119 Programi për ofrimin e shërbimeve te energjisë ne ulje te shpenzimeve financiare ne Komunën e Prishtinës sipas UA nr.06-2021” me numër të prokurimit 616-24-3272-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues LCE SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë: Tenderuesi i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar të dhëna teknike, datasheet ose dokumente të ngjashme për pozicionin 12: "Furnizimi, transporti dhe montimi i Koncentratorit, ose një pajisjeje të ngjashme, me karakteristika minimale ose të avancuara, si vijon:

- Koncentrator, një urë komunikimi ndërmjet serverit (GPRS/3G/4G/Ethernet) dhe LCU (nga Zigbee), i përditësuar përmes OTA, me tension pune 96-500VAC, 50-60Hz, konsumi >2W, klasë mbrojtjeje >IP54, temperaturë funksionimi nga -30°C deri në +70°C.
- Mikro-kontrollues i shkallës industriale, 32-bit, me performancë të lartë CPU ARM9.
- Bazohet në sistemin operativ Linux ose një platformë të ngjashme, e cila është shumë e besueshme.
- I pajisur me 10/100M Ethernet, RS485, dhe lidhje USB.
- Mbështet metodat e komunikimit në distancë përmes GPRS dhe Ethernet.
- Mundësi për përmirësim lokal ose në distancë përmes portës serike/diskut USB, Ethernet/GPRS.
- Mund të lexojë energjinë elektrike nga distanca, duke përdorur matës inteligjentë të integruar ose matës të jashtëm.
- 4 DO (dalje dixhitale), 8 DI (hyrje dixhitale, 6 DCIN + 2 ACIN).
- Bateri Fuli ose e ngjashme, 12V/12Ah/20h.

- Induktorë të dyanshëm për faza (induktorë mutualë).

Këto të dhëna teknike janë të kërkuara në kriteret mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 15 në FDT, ku specifikohet: ‘75. Operatori Ekonomik (Shërbyesit e energjisë) duhet të paraqesë specifikat teknike për koncentratorin, i cili komunikon me trupat ndriçues përmes Lamp Controller-it. Koncentratori duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve CE.’

Pretendimi i dytë: Tenderuesi i rekomanduar nuk ka plotësuar siç duhet deklaratat nën betim. Kjo përbën një kusht administrativ, dhe për këtë arsye, tenderuesi i rekomanduar duhet të eliminohej nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të rekomandohej për kontratë. Më konkretisht, mungon nënshkrimi i Operatorit Ekonomik (OE) në rubrikën e dedikuar për nënshkrim. Për pasojë, deklarata nën betim nuk është e vlefshme dhe nuk duhet pranuar nga Autoriteti Kontraktues (AK). Kjo vlen për të dy deklaratat e dy anëtarëve të Grupit të Operatorëve Ekonomikë (GOE).

Pretendimi i tretë: Deklaratat për formimin e Grupit të Operatorëve Ekonomikë (GOE) nuk janë hartuar sipas formularit të miratuar nga KRPP dhe në përputhje me Rregulloren e Prokurimit Publik (RRPP) në fuqi. Duke analizuar deklaratën për themelimin e GOE-së, është e qartë se tenderuesi i rekomanduar ka improvizuar dhe nuk ka respektuar modelin e deklaratës të publikuar në platformën e-Prokurim. Ky fakt përbën gjithashtu një shkelje të kushtit administrativ, dhe për këtë arsye, tenderuesi i rekomanduar duhet të eliminohej nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të rekomandohej për kontratë. Më poshtë do të gjeni fillimisht deklaratën, siç është dashur të përpilohet sipas formatit të KRPP, dhe më pas mund të shihni foton e deklaratës së dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 24/12/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1247/2024, ndërsa me datë 03/01/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/1247 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon *panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është deklaruar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE LCE SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1247 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në Pretendimet e OE ANKUES "Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se pikënisja e problemit ka të bëjë me atë se OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme sepse nuk e ka plotësuar deklaratën nën betim në siç kërkohet, dhe poashtu ka dorëzuar formatin e deklaratës për thelmetin e grupit të OE e cila nuk është e ngjashme me formën e paraqitur nga KRPP-ja. Pas shqyrtimit të provave shkresore vlerësojmë se dokumentat e kontestuara nga OE ankues – sa i përket deklaratës nën betim, OE i rekomanduar për kontratë për ta përmbushur këtë kërkesë me ofertë ka dorëzuar filen e emërtuar 1.1“ anex deklarata nën betim”, ka bashkangjitur deklaratat nën betim duke përdorur aneksi 2 të dosjes së tenderit për të dy anëtarët e konzerciumit. Vlerësojmë se në rastin konkret, deklaratat nën betim të dorëzuara nga gr. I OE të rekomanduar janë përputhje të plotë me aneksin 2 të dosjes pasi që i përmbajnë të dhënat e kërkuar dhe janë të nënshkruara dhe vulosura. Dilema tjetër e ngritur nga OE ankues është se geupi i OE të rekomanduar për kontratë, nuk e ka hartuar deklaratetn për formimin e grupit sipas formularit të KRPP dhe rregullores në fuqi. Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve/ dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike E-prokurimi, hapja e ofertave është bërë me dt 05.06.2024, dhe gr.i OE të rekomanduar për kontratë kanë dorëzuar me ofertë edhe filen e 3 të emërtuar “3. Declarate and JV_11.1&11.2” në kuadër të këtij file ka bashkangjitur edhe deklarata për themelimin e grupit, nëpërputhje me rregulloren nr. 001/2022, nga deklarata e dorëzuar për themelimin e grupit është caktuar lideri “FULI INZENIRING” SH.P.K, poashtu janë plotësuar edhe deklaratat si në vijim: a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës; b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit; dhe d. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT; e. Secili Operator Ekonomik i cili oferton në grup të operatoreve Ekonomik duhet të jete i regjistruar në platformën e e-Prokurimit. Vlerësojmë se në rastin konkret, pretendimi i OE ankues, se deklarata nuk e përmbanë formën sipas KRPP është i pa qëndrueshëm për faktin se ndryshimet e rregullores së re kanë hyrë në fuqi me dt 11.11.2024, kurse aktivitetit i prokurimit është iniciuar me dt 04.04.2024 dhe hapja e ofertave është bërë me dt 05.06.2024 pra ka qenë e pamundur që të dorëzohet forma e deklaratave për themelimin e grupit sipas njoftimit të KRPP siç pretendon OE ankues. Andaj mbi këtë bazë vlerësojmë se pretendimi i palës në ankes për këtë pikë është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin tjetër, se OE i rekomanduar nuk i ka dorëzuar specifikat teknike apo të ngjashme për pozicionin 12, Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë me ofertë në filen me nr 16 të emërtuar “16. Specifikat Teknike_9.1&9.2” ka bashkangjitur edhe specifikat teknike të nënshkruara dhe vulosura, konform kërkesës së dosjes së tenderit. Poashtu AK në arsyetimin e vendimit kur ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për ri-shqyrtim e ka arsyetuar secilëm pikë të pretendimit ankimor përfshirë edhe këtë, duke potencuar faktin se OE i rekomanduar për kontratë i përmbushë të gjitha specifikat teknike dhe janë të certifikuar me CE. Si përfundim, eksperti shqyrtues, po ashtu sqaron se mbetet në përgjegjësi dhe diskercion të Autoritetit kontraktues, respektivisht ZPP-së që vlerësimi i ofertave, të bëhet në përputhje të plotë me nenin 59 paragrafi 4 dhe me nenin 56 paragrafi 3 i LPP-së dhe nenin 72 paragrafi i LPP-së në atë mënyrë që lejonë trajtim të barabartë më mes të operatoreve ekonomik dhe të arrihet qëllimi i LPP-se dhe vlera për parën. Andaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme

vlerësojmë se pretendimi i palës në ankesë për këtë pikë është i paqëndrueshme

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjeNë rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik LCE SH.P.K., të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “119 Programi për ofrimin e shërbimeve te energjisë ne ulje te shpenzimeve financiare ne Komunën e Prishtinës sipas UA nr.06-2021” me numër të prokurimit 616-24-3272-2-1-1.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II dhe III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - LCE SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: